

PËRMBLEDHJE – JO TEKNIKE

**DEPOZITA PER DEPOZITIMIN E NAFTAES DHE
NENPRODUKTE TE SAJ**

Aktiviteti: Depozita nafte kapaciteti 12500m³.
Subjekti: KURUM INTERNATIONAL SH.A.
Investitori: Lindita KIKINO
Vendndodhja: Fshati Bradashesh, ish kombinati metalurgjik, Elbasan

1. HYRJE

Të dhëna për shoqërine

Shoqëria “Kurum International” Sh.A me Administrator/e Znj. Lindita KIKINO ka ndertuar dhe vene ne funksionim impiantin e depozitave te naftes dhe nenprodukteve te saj, i cili ndodhet ne rrethin e Elbasanit, në Fshatin Bradashesh tek ish kombinati metalurgjik.

Si nje shoqeri me aktivitet import dhe tregtim te naftes, per kryerjen e aktivitetit te depozitimit dhe tregtimit te naftes eshte e pajisur me Lejen Mjedisore nga ana e Ministrise se Mjedisit ne vitin 2014, me keto te dhena: Nr. 29 Prot Nr 1 Vendimi, date 21.01.2014.

Shoqeria “Kurum International” Sh.A. eshte themeluar ne vitin 1998, me aktivitet te sajn:

Import dhe eksport te karburanteve.

Informacion i shkurtër nga ana e investitorit mbi projektet qe ka zhvilluar

Aktiviteti i shoqerise “Kurum International” Sh.A gjate kesaj periudhe mund te permblihet si me poshte:

- ne aktivitetin e vet perfshihet depozitat e naftes
- ka nje staf inxhiniero-teknik prej 3 specialistesh
- ka rreth 6 punonjes
- ka ne pronesi te vet nje park te kompletuar te mjeteve teknologjike qe perdoren ne fushen e transportit te naftes.

Adresa e shoqerise:

Aktiviteti i saj zhvillohet ne Rrethin e Elbasanit. Selia e shoqerise eshte ne adresen: Tirane Njesia Administrative Nr.5,rruga Ibrahim Rugova, pallati nr.14 KT, "Green Park", apartamenti nr.39, kati 6.

2. VENDNDODHJA E DEPOZITAVE TE NAFTAES

Objekti ndodhet ne dalje te qytetit te Elbasanit, është jashtë zonës së banuar në fshatin Bradashesh, Ish Kombinati Metalurgjik, territor ky nën juridiksionin e Qytetit të Elbasanit.

Duke patur parasysh rrezikshmerine e larte qe paraqet ky impiant ne rast te ndonje zjarri aksidental, objekti eshte projektuar dhe ndertuar larg zones se banuar dhe afer rruges automobilistike, per te lehtesuar mundesine e nderhyrjes se shpejte ne rast se paraqitet nevoja.

Objekti eshte i sistemuar dhe kufizohet ne kater anet e saj me objekte ekonomike, te shoqerise ndersa ne pjesen ballore te saj eshte rruga hyrese. Kjo zone ka levizje te trafikut rrugor per ne qytetet jugore dhe veriore te vendit.

Territori ku jane instaluar depozitat e naftes eshte i rrethuar me mur te larte, dhe pergjate murit jane mbjelle peme te larta. Depozitate e naftes jane instaluar ne nje siperfaqe totale prej 7000 m² dhe ka nje kapacitet total depozitimi te naftes prej 12500 m³ (4 depozita me kapacitet 3000 m³ ,2 depozita me kapacitet 200m³ dhe 1 depozite me kapacitet 100 m³)

Siperfaqja totale e truallit ku eshte ndertuar Stacioni i depozitimit te naftes, se bashku me infrastrukturen ndihmese dhe funksionale eshte 7000 m².

Depozitat e naftes ndodhen ne parcelen me keto te dhena:

Zona Kadastrale	3965
Numri i Pasurise	687/2
Volumi	5
Adresa e Pasurise	Metalurgji
Bashkia	Elbasan

Kufizimet e pasurise jane:

nga Veriu	me pasurine 665,
nga Lindja	me pasurine 665
nga Jugu	me pasurine 665
nga Perendimi	me pasurine 665

3. PERSHKRIMI I ELEMENTEVE PERBERES TE IMPIANTIT TE GLN-se

Elementet kryesore te depozitave te naftes, te paraqitur ne menyre skematike ne Planimetirne e objektit jane si me poshte :

- Porta e hyrjes se autoboteve
- Kabina e rojes
- Ambjentet e zyrave
- Rezervuaret per naften, (4 depozita me kapacitet 3000 m³ ,2 depozita me kapacitet 200m³dhe 1 depozite me kapacitet 100 m³)
- Stacioni i pompave.
- Pika e shkarkimit te autoboteve
- Rezervuar uji per MNZ-ne me kapacitet 60 m³

Objekti i Impiantit te Depozitimit te naftes mund te konceptohet nga ana funksionale si nje pjese integrale e perbere nga tre seksione:

- Seksioni i pranimit te naftes, i cili perbehet nga mjetet transportuese te naftes me anekset perkatese;
- Seksioni i depozitimit te naftes, i cili perbehet nga (4 depozita me kapacitet 3000 m³ ,2 depozita me kapacitet 200m³dhe 1 depozite me kapacitet 100 m³), si dhe anekset perkatese;
- Seksioni i mbushjes se mjeteve, i cili perbehet nga pistoletat e mbushjes

Përbërësit kryesorë të naftës janë hidrokarburet. Kryesisht arenet, alkanet dhe cikloalkanet. Në naftë gjenden dhe komponime që pëmbajnë oksigjen, azot dhe squfur. Komponimet e azotit dhe squfurit i japin naftës erë jo të këndshme.

Vetitë fizike të naftës varen nga pëbërja kimike e saj. Nafta është lëndë bazë e industrisë kimike që quhet *Petrokimi*.

4. TE DHENA PER FUNSIONIMIN E IMPIANTIT TE GLN-se

Depozitat e naftes do te funksionojne ne menyre te ngjashme si me nje magazine per ruajtje e saj ne sasira relativisht te medha, dhe njekohesisht te perdorimit te saj sipas kerkesave te shoqerise). Pra, ne menyre te thjeshtuar kemi te bejme me konceptin “magazinim” per qellime ruajtje dhe “perdorim vetjak”.

Pra, kemi te bejme me procese ruajtje dhe perdorimi vetjak te produkteve te gatshme, pa procese perpunimi. Ne keto kushte te zhvillimit te aktivitetit (*ruajtje dhe perdorim te naftes*) procesi eshte krejt konvencional me menyren si funksionojne dhe jane te perbere keto impiante.

Lenda e pare (Naftë) sigurohet nga subjektet qe kryejne importin e saj me shumice, pasi jane pergatitur kontratat me firmat importuese qe bejne shitje me shumice te saj.

Nafta transportohet me autobotet e shoqerise per ne Impiantin e Shoqerise, dhe depozitohet ne shtate depozitat qendrore stacionare te Impiantit. Ne keto impiant jane te instaluar gjithsej 4 depozita me kapacitet 3000 m³, 2 depozita me kapacitet 200m³ dhe 1 depozite me kapacitet 100m³.

Kapaciteti total i depozitave te naftes eshte 12500 m³

Kanali i grumbullimit te ujrave dhe karburanteve qe eventualisht mund te derdhen gjate manipulimit te tyre, do te perfundojne ne separatorin e ndarjes se hidrokarbureve nga uji;

Çisterna e depozitimit te hidrokarbureve mbetje do te grumbulloje mbetjet e ndotjet gjate aktivitetit, dhe mbas nje cikli kohor do te mblidhen keto te fundit per t’u dorezuar per djegie apo riciklim sipas procedures se udhezuar nga ARM-ja e Qarkut Tirane;

Rezervuaret (kapacitetet depozituese) metalike do te jene me spesor mbi 4 mm, te tipit cilindrik horizontal, te lyer me boje anti korodive dhe dy duar shtrese bituminoze. Bokaportet, linjat e furnizimit te dyfishte si dhe tubat e ajrimin do te jene te montuar ne rezervuare konform kerkesave tekniko-teknologjike te eneve nen presion. Ato do te vendosen ne gropa me vaska betoni te hidroizoluara dhe me material termoizolues e stabilizant. Mbas montimit te tyre dhe lidhjes se linjave te furnizimit me distributoret, ato do te provohen per ndonje carje te mundeshme, duke aplikuar nje presion hidraulik prej minimumi 0,75 kg/cm²;

Furnizimi i rezervuareve me karburante do te behet me autobote, parametrat teknike e teknologjike te te cileve do te jene ne perputhje me kerkesat e eneve nen presion. Shkarkimi i karburanteve prej tyre do te behet nepermjet tubave te gomuar qe sigurojne nje rrjedhje me presion konstant ne tubacionet e pusetave perkatese mbi bokaportet e rezervuareve. Muftat bashkuese ne te dy ekstremet e tubit te gomuar do te jene objekt i rendesishem kontrolli per riparim apo zevendesim te mundeshem ne rast demtimi.

Furnizimi me karburant do te behet ne distributor universal nepermjet pistoletave. Distributori do te jete i vendosur ne bazament betoni duke respektuar rigorozisht balancimin, distancat e lirshmerite ne manipulimet e ndryshme ne to e perreth tyre. Gjate sherbimit, kolaudimit apo ndonje riparimi te mundshem te pjeseve te distributoreve (pompa, tubat fleksibel, pistoleta, etj.), do te merren masa qe karburantet te derdhen ne ene te posacme apo kanale lengmbledhes qe do te ndertohen prane distributoreve dhe qe vazhdojne per t'i rikthyer ne depozite, pa lejuar rrjedhje ne mjedis

5. KAPACITETI I DEPOZITIMIT TE DEPOZITAVE TE NAFTAES

Kapacitetet depozituese se Depozitimit do te jene 7 rezervuare mbitokesore per depozitim te naftese. Secili prej tyre do te kete kapacitet prej $4 \times 3000 \text{ m}^3$, $2 \times 200 \text{ m}^3$ dhe $1 \times 100 \text{ m}^3$.

Paretet e ketyre rezervuareve jane te trashesisse:

Ballore	> 6 mm
Anesore	> 6 mm

Nafta transportohet me autobotet e shoqerise per ne Impiantin e Shoqerise, dhe depozitohet ne 7 depozitat qendrore stacionare te Impiantit. Ne kete impiant jane te instaluar gjithsej 7 cisterna, me kapacitet depozitues $2 \times 3000 \text{ m}^3$, $2 \times 200 \text{ m}^3$ dhe $1 \times 100 \text{ m}^3$.

Kapaciteti total i depozitave te naftes eshte 12500 m^3

Furnizimi i automjeteve te shoqerise me nafte do te behet me anen e pajisjeve bashkekohore, duke siguruar eliminim te plote te rrjedhjeve.

Depozitat e naftes do te furnizojne, nepermjet linjave teknologjike nentokesore, 2 distributore me 2 pistoleta aktive. Depozitat jane instaluar ne pjesen qendrore/anesore te Impiantit, dhe jane te vendosura ne jasteke betoni siperfaqja e tokes. Lidhjet teknologjike jane te vendosura ne lartesi te pakten 1 meter nga siperfaqja e tokes.

Përgatiti raportin:

KURUM INTERNATIONAL Sh.A

Lindita KIKINO